

Përshpejtim i veprimit për angazhimet për të përmirësuar zbulimin e diabetit dhe cilësinë e kujdesit

28 – 29 Nëntor 2023 | Beograd, Serbi

Deklaratë për përshpejtimin e veprimit për angazhimet për të përmirësuar zbulimin e diabetit dhe cilësinë e kujdesit

1. Ne, Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO), agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, përmes Zyrës së saj Rajonale për Europën, dhe Federata Ndërkombëtare e Diabetit (IDF) – Europë, një organizatë ombrellë jofitimprurëse e shoqatave kombëtare të diabetit, nënshkruese të kësaj Deklarate që rrjedh nga Samiti Teknik i nivelit të lartë për Zbatimin e Përshpejtuar të Angazhimeve për të Përmirësuar Zbulimin e Diabetit dhe Cilësinë e Kujdesit, i pranojmë rolet dhe mandatet tona përkatëse, dhe bëhemi së bashku për të ofruar mbështetje Shteteve Anëtare.
2. Ne e njohim përpjekjen e rëndësishme të bërë nga Shtetet Anëtare për të reduktuar vdekshmërinë e parakohshme dhe për të përmirësuar zbulimin, diagnostikimin dhe trajtimin e diabetit në Rajonin Europian të WHO-së.
3. Rikujtojmë qëllimet dhe detyrimet në vijim:
 - Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, në veçanti Qëllimi për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG) 3 Objektivi 4 për të reduktuar me një të tretën vdekshmërinë e parakohshme nga sëmundjet jotransmetuese dhe Objektivi 8 për të arritur një mbulim universal shëndetësor;
 - Rezoluta 74.4 e Asamblesë së 74-t Botërore të Shëndetësisë, për reduktimin e barrës së sëmundjeve jotransmetuese përmes fuqizimit të parandalimit dhe kontrollit të diabetit;
 - Qëllimet globale të mbulimit të diabetit deri në vitin 2030 të miratuara në Asamblenë e 75-të Botërore të Shëndetësisë;
 - planet globale dhe europiane të veprimit për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve jotransmetuese;
 - Deklarata e Ashgabatit për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Jotransmetuese në Kontekst të Shëndetësisë 2020;
 - Marrëveshja Globale e WHO-së për Diabetin; dhe
 - për Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian, Rezoluta e Parlamentit Europian për parandalimin, menaxhimin dhe kujdesin më të mirë të diabetit në Bashkimin Europian me rastin e Ditës Botërore të Diabetit.

4. Ne vëmë re se pavarësisht këtyre angazhimeve, numri i njerëzve të cilët jetojnë me diabet në Rajonin Europian të WHO-së vazhdon të rritet; sipas vlerësimeve të IDF-së, një e treta mbetet e padiagnostikuar, dhe gati gjysma mund të mos i përmbushin objektivat e tyre të trajtimit. Ne shprehim shqetësim lidhur me shpejtësinë dhe efektivitetin e zbatimit.
5. Ne theksojmë rolin që parandalimi dhe menaxhimi efektiv i diabetit mund të luajë në kontribuimin për sisteme më të rrezistueshme dhe të qëndrueshme shëndetësore.
6. Ne i pranojmë sfidat në rritje me të cilat përballen sistemet shëndetësore kombëtare në një “epokë të permakrizës” dhe prioritetet konkurruese, të cilat heqin dorë nga investimet dhe përqëndrohen në parandalimin cilësor dhe menaxhimin në kohë të sëmundjeve jotransmetuese siç është diabeti, dhe prandaj bëjmë thirrje në pranimin e detyrimeve të ndërmarra dhe ripërtëritje e fokusit në veprimet për përshpejtimin e progresit drejt objektivave të dakorduara.
7. Ne jemi të shqetësuar për ndikimin e të gjitha rreziqeve në vazhdimësinë e kujdesit për njerëzit të cilët jetojnë me diabet dhe sëmundje të tjera jotransmetuese dhe pranojmë se ata janë ndër më të prekurit – për shembull njerëzit me diabet janë në një rrezik më të lartë për t’u sëmurë më rëndë ose të vdesin nga sëmundja e koronavirusit (COVID-19).
8. Ne shprehim shqetësim se numri i njerëzve të cilët jetojnë me diabet është në rritje kur disa tipe të diabetit mund të parandalohen, dhe vërejmë se numri i rritur i njerëzve të cilët jetojnë me diabet është i lidhur fort me parandalimin e pamjaftueshëm të faktorëve të rrezikut që janë baza e diabetit, siç është mbipeshja dhe obeziteti, dietat jo të shëndetshme, pasiviteti fizik dhe përdorimi i duhanit, dhe lidhet me statusin shoqëroro-ekonomik dhe ndikimin e përcaktuesve shoqëror, ekonomik dhe mjedisor të shëndetit.
9. Ne e njohim rëndësinë e një qasjeje që përfshin tërë qeverinë dhe tërë shoqërinë dhe angazhimin dhe bashkëpunimin e palëve të interesit ndërmjet WHO-së, aktorëve joshitetërorë, si IDF, dhe Shtetet Anëtare në avancimin e planeve kombëtare, rajonale dhe globale për parandalimin dhe kontrollin e diabetit.
10. Për më tepër, ne pranojmë rëndësinë e një angazhimi kuptimplotë (të respektueshëm, dinjitoz dhe të barabartë) të njerëzve me përvojë të përjetuar në të kuptuarit dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara në mënyrë që të hartojmë, zbatojmë, monitorojmë dhe vlerësojmë zgjidhjet përkatëse së bashku.
11. Mirëpresim vlerën e shtuar të bashkëpunimit me Forumin Europian të Diabetit dhe fuqinë dhe potencialin e partneritetit me shoqatat e tyre anëtare.
12. Ne e njohim rëndësinë e Veprimit të Bashkuar për Shëndet më të Mirë në Europë dhe të një ekonomie të mirëqenies e cila siguron qasje universale në kujdes cilësor pa vështirësi, që i vendos njerëzit në qendër të shërbimeve dhe që synon reduktimin e pabarazive shëndetësore për të mbyllur boshllëqet në rezultatet shëndetësore dhe për të mos lënë askënd prapa, siç përshkruhet në Programin Europian të Punës të WHO-së 2020-2025.

13. Ne pranojmë se qeveritë janë të vetëdijshme për këto detyrime dhe tashmë janë duke marrë masa të rëndësishme për t'i adresuar ato, megjithatë përballen me rritje të sfidave në zbatim, dhe prandaj u bëjmë thirrje Shteteve Anëtare, pas diskutimeve gjatë Samitit, për të ndërmarrë veprime të mëtejshme në përputhje me Rezolutën 74.4 të Asamblesë Botërore të Shëndetësisë:

(1) për të aplikuar qasjet e tërë qeverisë dhe tërë shoqërisë të cilat e vendosin arritjen e pesë objektivave vullnetare globale lidhur me diabetin dhe obezitetin në qendër të përgjigjes;

(2) për të ngritur, brenda përgjigjeve kombëtare të sëmundjeve jotransmetuese, prioritetin që i jepet parandalimit dhe kontrollit të diabetit, përfshirë menaxhimin e obezitetit, diagnostikimit të hershëm, trajtimin, kujdesin dhe menaxhimin e komplikimeve, duke marrë parasysh prioritetet kombëtare;

(3) për të fuqizuar masat politike, legjislative dhe rregullatore, duke përfshirë masat fiskale si të përshtatshme, për të synuar minimizimin e ndikimit të faktorëve kryesorë të rrezikut për diabet dhe promovimin e dietave dhe mënyrave të jetesës së shëndetshme;

(4) për të rritur ndërgjegjësinë për barrën kombëtare publike shëndetësore të shkaktuar nga diabeti, përmes perspektivës së jetëgjatësisë, dhe për marrëdhënien ndërmjet diabetit, varfërisë dhe zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, si dhe për marrëdhënien ndërmjet obezitetit dhe rrezikut për zhvillim të diabetit tip 2;

(5) për të siguruar përqëndrim të vazhdueshëm në mirëmbajtjen e nivelit të lartë të mjekimit dhe kujdesit për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh pandeminë e COVID-19, përfshirë edhe njerëzit të cilët jetojnë me diabet, në veçanti në vendet me të ardhura të ulta dhe të mesme, duke pranuar se përpjekjet e domosdoshme të parandalimit dhe kontrollit të diabetit janë vështirësuar nga, ndër të tjera, mungesa e qasjes universale për shërbime jetike cilësore, të sigurta, efektive, të përballueshme të shëndetit, medikamente, diagnostikime dhe teknologji shëndetësore, si dhe nga mungesa globale e punonjësve të kualifikuar shëndetësor;

(6) për të siguruar që strategjitë kombëtare për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve jotransmetuese përmbajnë dispozitat e domosdoshme për të mbuluar personat të cilët jetojnë me diabet me shërbime jetike cilësore shëndetësore dhe për të promovuar qasjen në diagnostikimet dhe medikamentet jetike cilësore, të sigurta, efektive, të përballueshme, duke përfshirë insulinën, agjentët hipoglikemik oral dhe medikamente të tjera në lidhje me diabetin dhe teknologjinë shëndetësore për të gjithë njerëzit të cilët jetojnë me diabet, në përputhje me kontekstin dhe prioritetet kombëtare;

(7) për të fuqizuar sistemet shëndetësore dhe cilësi të lartë, shërbimet shëndetësore parësore për të gjithë të integruara dhe të përqëndruara të njerëzit, sistemet informative të menaxhimit shëndetësor, dhe fuqi punëtore shëndetësore të përshtatshme të mirë trajnuar dhe të pajisur, duke pasur parasysh kontekstet kombëtare;

(8) për të përmirësuar parandalimin dhe kontrollin e diabetit gjatë gjithë jetës përmes reduktimit të faktorëve të rrezikut të modifikueshëm dhe të parandalueshëm për diabetin, përfshirë obezitetin dhe pasivitetin fizik, dhe qasje më të mirë në diagnostikime jetike të sigurta, të përballueshme, efektive dhe cilësore, medikamente dhe produkte të tjera të lidhura me shëndetin;

(9) për të fuqizuar promovimin e shëndetit dhe përmirësimin e arsimimit shëndetësor, duke përfshirë qasjen miqësore ndaj pacientit me informacione dhe edukim të kuptueshëm dhe me cilësi të lartë;

(10) për të forcuar monitorimin dhe vlerësimin e përgjigjeve ndaj diabetit, përmes sistemeve të mbikëqyrjes dhe monitorimit në nivel të vendit, përfshirë sondazhet, të cilat janë të integruara në sistemet ekzistuese kombëtare për informacionet shëndetësore, dhe duke identifikuar fushat prioritare për hulumtimin e diabetit;

(11) për të vazhduar punën me bashkëpunim, në përputhje me kornizat dhe kontekstet ligjore kombëtare dhe rajonale, për të përmirësuar raportimin për informacionet nga ana e furnitorëve në medikamentet e regjistruara të diabetit dhe produkte të tjera të lidhura me shëndetin.

14. Si Zyra Rajonale e WHO-së për Europën dhe IDF Europë, jemi dakord për të mbështetur Shtetet Anëtare që të përshpejtojnë progresin drejt përbushjes ose tejkalimit, aty ku është e mundur, të objektivave globale të diabetit për vitin 2030:

- 80% e njerëzve që jetojnë me diabet janë të diagnostikuar;
- 80% kanë kontroll të mirë të glikemisë;
- 80% e njerëzve me diabet të diagnostikuar kanë kontroll të mirë të presionit të gjakut;
- 60% e njerëzve me diabet në moshë 40 vjeçare e sipër pranojnë statinë; dhe
- 100% e njerëzve me diabet të tipit 1 kanë qasje në insulinë të përballueshme dhe vetëmonitorim të glukozës në gjak.

15. Ne e pranojmë se për të arritur progres domethënës, është e rëndësishme që të përfshihen të gjitha palët e interesit, në veçanti njerëzit të cilët jetojnë me diabetin, dhe pikërisht në këtë frymë bashkëpunimi ne parashtruan këtë Deklaratë.